



TET 2021



TITUJT

EDITORIAL Koordinator i përhershëm i OKB-së

Editorial: UN Day [faqja 1](#)

Përgjigja ndaj COVID-19 dhe aktivitetet tjera të OKB-së [faqet 2, 3 & 4](#)

Në fokus Common Agenda [faqja 4](#)

sonë dhe ndaj planetit tonë.



Dhe së treti, duhet të kuptojmë se për këtë duhet të punojmë së bashku. Ne duhet t'i lëmë pas vetes të gjitha dallimet dhe keqkuptimet tona nga e kaluara. Duhet të sigurohemi që nuk ka prioritet më të madh se zhvillimi i qëndrueshëm.

Maqedonia e Veriut ka arritur disa ndryshime vërtet të jashtëzakonshme drejt përbushjes së OZHQ-ve në periudhën e kaluar. Gjatë vitit 2020, mes sfidës më të madhe shëndetësore të dekadave të fundit, vendi e realizoi Rishikimin e tij të parë Vullnetar Kombëtar për ta matur progresin në agjendën e OZHQ-së. Në mes të pandemisë COVID-19, Maqedonia e Veriut shpallti zotim të reja nacionale për klimën përmes reduktimit të gazeve serrë dhe e nisi procesin e zhvillimit të Strategjisë Nacionale të Zhvillimit, instrument i cili do ta përfshijë të gjithë vizionin e shoqërisë për një të ardhmen më të mirë, më të drejtë dhe më të gjelbër për të gjithë.

Por megjithatë nuk mjafton. Kjo është arsyeja pse këtë vit me rastin e shënimit të Ditës së OKB-së, e shpalla fushatën tonë të parë lokale shumëvjeçare të avokimit të hapur të quajtur "Unë kujdesem" / "I care". Qëllimi i fushatës do të jetë që t'i mobilizojë organizata nga të gjitha segmentet e shoqërisë, si dhe individët nga të gjitha sferat e jetës, në mënyrë që t'i nxis ata të kontribuojnë në mënyrë aktive në zotimin tonë të përbashkët për një të ardhme më të gjelbër, më të mirë dhe më të qëndrueshme.

Meqenëse është një platformë e hapur, të gjithë mund të bashkohen dhe të kontribuojnë në përmirësimin e standardeve të jetesës, për punë më të denja dhe të gjelbra, për të drejtat universale për kujdes shëndetësor cilësor, të arritshëm dhe të përbalueshëm, asim dhe mbrojtje të nevojshme sociale dhe të fëmijëve dhe për veprim ambicioz për klimën dhe mbrojtjen e biodiversitetit. Me këtë fushatë duam ta mbijellim qasjen e qëndrueshme të të gjithë ne, që t'i bëjmë ndryshimet e nevojshme dhe ta arrijmë të ardhmen që e dëshirojmë.

Këto ndryshime mund të ndodhin vetëm nëse me të vërtetë e arrijmë qasjen e të gjithë shoqërisë. Ne popujt, bashkërisht jemi zotuar për një të ardhme më të mirë për të gjithë dhe duhet të tregojmë se kujdesemi vërtet, duke e bërë atë realitet.

Rossana Duxhak
Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Maqedoninë e Veriut

Gjatë krenimit të sivjetmë të Ditës së OKB-së, mes të gjitha veprimeve dhe vendimeve tona, në fokus kryesor ishte përkujdesi që zhvillimi i qëndrueshëm të jetë prioritet parësor për të gjithë, duke shtuar këtu edhe konstatimin e pashmangshëm të përkushtimeve tona të përbashkëta brenda OKB-së, si pjesë e Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm si në nivelin lokal, po ashtu edhe në atë global.

Fjalët e para të Kartës së OKB-së - "Ne, popujt e Kombeve të Bashkuara..." - e simbolizojnë me vërtetësi të plotë rëndësinë e angazhimit të vendeve anëtare të OKB-së për të punuar së bashku për arritjen e paqes, prosperitetit dhe respektimit e të drejtave të njeriut. Ky është zotim, që e kemi marrë të gjithë përsipër. Pra varet nga të gjithë ne, pasi që jemi NE POPUJT, që jemi angazhuar të punojmë së bashku për ta zhdukur urinë dhe varfërinë, për ta mbrojtur planetin dhe për të siguruar një të ardhme më të mirë, më të drejtë dhe më të gjelbër për ne dhe për të gjitha brezat e ardhshëm. Nuk varet vetëm nga qeveritë, nga OKB-ja apo nga dikush tjetër.

Në të gjitha segmentet është arritur progres në zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, si në nivel global, po ashtu edhe në atë lokal. Prandaj ne duhet t'i vlerësojmë përpjekjet e bëra deri tani, ndonëse kjo nuk mjafton. Duke filluar me më të dukshmen - pandeminë COVID-19 - dhe duke vazhduar me realitetin gjithnjë e më të ashpër të ndryshimit të klimës, ne kemi pranuar mesazhe të forta se ato përpjekje nuk janë të mjaftueshme. Edhe më shumë se kaq, tani është e qartë, nëse të gjithë ne nuk ndërmarrim veprime qoftë individualisht dhe bashkërisht, do të vihet në rrezik e ardhmja që donim për ne dhe për fëmijët dhe nipërit tanë.

Ne njerëzit duhet të gjejmë edhe më shumë mënyra për të punuar së bashku dhe për t'i përshpejtuar zgjidhjet e qëndrueshme për sfidat më të mëdha të botës. Së pari, ne duhet të kuptojmë se Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm paraqesin përkushtim për një të ardhme më të mirë për të gjithë ne dhe se ato nuk i përkasin OKB-së, qeverisë, apo ndonjë organizate tjetër ose ndonjë grupi njerëzish. Ato na përkasin të gjithëve neve.

Si pikë e parë, pavarësisht nëse përpjekjet tona bazohen në Agjendën 2030, në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian ose në prioritetet nacionale, ne në parim punojmë në të njëjtën platformë, dhe në fund të fundit për të njëjtin qëllim - përshpejtimin e zhvillimit të qëndrueshëm për hir të të gjithëve.

Së dyti, ne duhet t'i zbatojmë në praktikë ato përkushtime. Të gjithë ne duhet ta zbatojmë një qasje të qëndrueshme në të gjitha veprimet apo mosveprimet tona, në të gjitha zgjedhjet ditore që i bëjmë për çdo ditë. Qasja e qëndrueshme duhet të jetë pjesë integrale e të gjitha veprimeve të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, duke filluar nga ushqimi që hamë, të ndikimi që kemi ndaj vetes sonë, ndaj familjeve tona, miqve, bashkësisë

DATAT KYÇE

TETOR

- 6** përmes Programit global për armët e zjarrit, UNODC vazhdoi t'i ofrojë mbështetje grupit të punës (GP) për ndryshimin e Kodit Penal në Maqedoninë e Veriut përmes një takimi në internet platformë dhe diskutimeve të vazhdueshme për çështje të ndryshme me anëtarët e grupit të punës, duke përfshirë masat e veçanta hetimore dhe harmonizimin me UNTOC dhe Protokollin e tij për armët e zjarrit.
- 20** Deklarata e të rinjve për klimën e miratuar në Samitin e të rinjve mbi klimën - një iniciativë e udhëhequr nga të rinjtë e mbështetur nga UNICEF dhe ambasadat italiane, suedeze dhe britanike në Maqedoninë e Veriut
- 28-29** zyra e UN Women në Maqedoninë e Veriut organizoi një punëtori për shkëmbim të ideve dhe përvojave, që mblodhi së bashku përfaqësues të OSHC-ve, të cilët punojnë në iniciativë të ndryshme për fuqizimin e grave dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në procesin e vendimmarrjes në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, në kuadër të projektit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

PËRGJIGJA NDAJ KOVID-19 DHE AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

Agjencitë e OKB-së vazhdojnë ta mbështesin veprimin kundër KOVID-19 në vend me ndërhyrje specifike dhe analiza të thelluara, të fokusuara në çështjet brenda fushave të tyre përkatëse të ekspertizës.

Për t'i mbështetur përpjekjet shtetërore në sigurimin e qasjes dhe disponueshmërisë ndaj shërbimeve cilësore të shëndetit seksual dhe riprodhues edhe gjatë pandemisë së KOVID-19, UNFPA-ja e drejton prokurimin e pajisjeve dhe zbatimin e projektit të mbështetjes nga Gjermania dhe Qendra për Kontroll të Sëmundjeve (QKS) e SHBA-ve me mbështetjen teknike të OBSH-së.

OBSH-ja ia dorëzoi Ministrisë së Shëndetësisë/Institutit të Shëndetit Publik pesë bartës të vaksinave dhe 1250 teste dhe reagjentë për sekuenca virale, të cilat do të kontribuojnë në një përgjigje efektive ndaj KOVID-19 në Maqedoninë e Veriut. Prokurimi i pajisjeve dhe zbatimin e projektit të mbështetjes nga Gjermania dhe Qendra për Kontroll të Sëmundjeve (QKS) e SHBA-ve me mbështetjen teknike të OBSH-së.

Në periudhën 18-25 tetor 2021 për herë të fundit ekspertët e OBSH-së e përfunduan një mision teknik në Maqedoninë e Veriut, si pjesë e bashkëpunimit të ngushtë të vazhdueshëm me autoritetet nacionale shëndetësore, që synojnë fuqizimin e gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave shëndetësore, përfshirë kontrollin e KOVID-19.

OBSH-ja e mbështeti konferencën "Rritja e rimëkëmbjes dhe qëndrueshmërisë së komunitetit rom ndaj emergjencave përmes veprimeve pjesëmarrëse dhe proaktive", të organizuar nga Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave – ESE. Në partneritet me ESE, OBSH-ja iu mundëson, i angazhon dhe fuqizon organizatat e komunitetit që të bëhen "shtytës të ndryshimit" dhe ta rrisin rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë e komunitetit rom ndaj emergjencave.

Meqenëse komunikimi i rrezikut dhe angazhimi i komunitetit është me rëndësi thelbësor që përgjigjet nacionale ndaj KOVID-19 të jenë efektive dhe të kenë ndikim pozitiv afatgjatë, OBSH-ja vazhdon ta lehtësojë qasjen në informacione që shpëtojnë jetë, gjegjësisht shërbimet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë imunizimin kundër KOVID-19, veçanërisht për komunitetet e rrezikuara si punonjësit e kujdesit shëndetësor, të moshuarit dhe popullsinë rome. Në kuadër të këtyre përpjekjeve u organizuan edhe trajnime për mjekët familjarë për "Komunikim me pacientët rreth vaksinimit kundër KOVID-19".

OTHER UN ACTIVITIES

Një grup mjetesh novatore që e kanë rritur transparencën e komunave në vend po konkurrojnë në përzgjedhjen për angazhimin më me ndikim në Evropë në kuadër të Open Government Awards (Çmimet për qeveri të hapur), që ndahen në nivel global si pjesë e dhjetëvjetorit të nisjes së partneritetit të qeverisjes

së hapur. Angazhimi për komuna transparente zbatohet nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale në bashkëpunim me UNDP-në dhe partnerët tjerë në kuadër të projektit "Fuqizimi i Këshillave Komunale", i mbështetur financiarisht nga Agjencia Zvicereane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Një projekt i financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) "Ndërtimi i kapaciteteve komunale për zbatimin e projektit" shënon përparim të

kontrollit tatimor me zyrtarët e DAP-it përmes një qasjeje në kohë reale "mësim duke punuar". Ndërtimi i kapaciteteve për reformën e transferimit të çmimeve është shumë i rëndësishëm në drejtim të luftës efektive kundër evazionit fiskal dhe mashtrimeve tatimore. Projekti "Mbështetje për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut" zbatohet me mbështetje financiare dhe ekspertizë të ofruar nga Ministria e Financave e Republikës së Sllovakisë.



Zhivka Gjurçinovska, Tumçevishtë/Gostivar, Maqedonia e Veriut, shtator 2021. Fotografuar nga: UN Women/Mirjana Nedeva

konsiderueshëm në plotësimin e dokumentacionit teknik të detajuar për afro 60 projekte infrastrukturore prioritare në të gjithë vendin. Dokumentacioni teknik gjithëpërfshirës, i azhurnuar hap mundësi të rëndësishme për mobilizim të burimeve për investime të synuara të mëvonshme në infrastrukturën sociale, mjedisore dhe të biznesit. Në mbështetje të këtyre përpjekjeve, më 3 nëntor 2021 u zhvillua një konferencë e nivelit të lartë për mobilizimin e burimeve, e cila mbledhi së bashku zyrtarë të lartë të qeverisë dhe përfaqësues të komunitetit të donatorëve. Konferenca përmbledhi gjithashtu përvojat nga pilotimi i Fondit të Dokumentacionit Teknik (FTD) – një instrument financimi novator, që ndihmon vetëqeverisjet vendore të japin përparësi dhe të ofrojnë infrastrukturë që do të sigurojë kushte më të mira jetese për qytetarët e tyre.

UNICEF-i, ambasada e Britanisë së Madhe dhe "Svetot na Bibi" (Bota e Bibit) e filluan një iniciativë të re për mbështetje të prindërve në zhvillimin e shkathtësive, që iu nevojiten për të shfrytëzuar aktivitetet e mbështetura në lojë për ndërtim të zhvillimit social dhe emocional të fëmijëve. Iniciativa e re përfshin një sërë tregimesh të animuara, libra me ilustrime dhe materiale tjera për mbështetje të mësimin social dhe emocional që nga vitet e hershme të jetës. Kjo iniciativë e re e UNICEF-it, dhe Botës së Bibit, e financuar nga ambasada e Britanisë së Madhe u nis në një punëtori në platformë të internetit, në të cilën prindërit kishin mundësi të angazhohen së bashku me ekspertët dhe të dëgjojnë sugjerime praktike për aktivitetet, që t'u ndihmojnë fëmijëve të mësojnë si t'i dallojnë dhe të përballen me emocionet.

"Trajnimet në vendin e punës" për punonjësit e Drejtorisë së të Ardhurave Publike në temën "Transferimi i çmimeve" u zhvilluan në javën e parë të tetorit, në kuadër të projektit të UNDP-së për Mbështetje të Reformës së Menaxhimit të Financave Publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Dy konsulentë nga Sllovakia dhe një konsulent vendor i ndanë njohuritë dhe aftësitë e tyre të

Në "Samitin Rinor mbi Klimën" të drejtuar nga të rinjtë në Shkup, të rinjtë nga vendi e miratuan Deklaratën rinore mbi klimën, duke u bërë thirrje vendimmarrëse të ndërmarrin veprime specifike për klimën dhe duke kërkuar më shumë mundësi dhe hapësirë për t'i nxitur zgjidhjet klimatike. Samiti Rinor mbi Klimën u mbështet nga UNICEF-i së bashku me ambasadat italiane, suedeze dhe britanike në Maqedoninë e Veriut dhe u organizua pas "Youth4Climate – Driving ambicie" (Të rinjtë për klimën – Ambicie shtytëse) në Milano dhe para Konferencës së 26-të të Palëve të OKB-së për Ndryshimet Klimatike në Glasgow. Samiti në fjalë, bazohet në iniciativën "Rriimagjino të ardhmen" të Kabinetit të Presidentit Pendarovski dhe UNICEF-it, një iniciativë konsultimi për të rinjtë që u jep fëmijëve dhe të rinjve hapësirë për t'u angazhuar në përcaktimin e vizionit që e duan për të ardhmen e tyre.

UNICEF-i e filloi serinë e dytë të uebinareve Eduino, që i adresojnë nevojat e mësuesve për metoda hibride të mësimdhënies si dhe praktika dhe qasjet tjera inovative të mësimdhënies.

Për forcim të kapaciteteve të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuençës së të Miturve është përgatitur një raport rreth iniciativave për zhvillimin e kapaciteteve. Në periudhën në vijim do të organizohen punëtori dhe trajnime për inkorporim të praktikave dhe qasjeve inovative në kryerjen e kërkimit dhe arrijtjen e përfutjes dhe palëve të interesuara në nivel nacional dhe lokal. Për ta siguruar pjesëmarrjen e fëmijëve, UNICEF-i mbështet në angazhimin e 60 adoleshentëve, të cilët do të bëhen avokatë të drejtësisë për fëmijët dhe do të hartojnë dhe zhvillojnë ide për qasje të barabartë në drejtësi. Është publikuar thirrja e hapur për avokatët e të rinjve dhe kanë filluar përgatitjet për trajnimin



Youth Climate Summit in Skopje supported by UNICEF together with the Italian, Swedish and British Embassies in North Macedonia.

AKTIVITETET TJERA TË OKB-SË

Për herë të tretë UNHCR-ja e mbështeti Festivalin Mediatik Shkupi 2021 i organizuar çdo vit nga PINA. Në kuadër të programit, festivali organizoi një diskutim me temën e mbulimit mediatic të refugjatëve dhe personave pa shtetësi. Gazetarët folën për përpjekjet e tyre për ta tërhequr vëmendjen e publikut për problemet serioze, por për fat të keq, pavarësisht kësaj, ata arritën në përfundimin se mediat janë të pafuqishme në mungesë të ndryshimeve sistematike.

UNHCR-ja e vazhdoi partneritetin me Festivalin e Jazz-it të Shkupit, me një natë festivali kushtuar kauzës sonë të përbashkët për Solidaritetin me Refugjatët. UNHCR-ja i mbështet përpjekjet e Festivalit të Xhazit të Shkupit dhe përkushtimin për edukim mbi xhazhin dhe muzikën botërore, por edhe për vlerat për të cilat duhet të përqihen të gjithë në shoqëri. Këtë vit bashkëpunimi ynë financohet nga Fondi i Mirëbesimit me më shumë Partner për Migracionin.

Rreth 30 pjesëmarrës nga institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile maqedonase dhe slovene morën pjesë në shkëmbimin online, të mbështetur nga UNHCR për integrimin dhe mjetet e jetesës ndërmjet autoriteteve dhe OSHC-ve të Maqedonisë së Veriut dhe Sllovenisë. Shkëmbimi ishte një mundësi për diskutime mbi strategjitë dhe politikat që lidhen me integrimin, duke përfshirë shërbimet thelbësore si përvetësimi i gjuhës, punësimi dhe arsimi, të gjitha në përputhje me planin e veprimit për Integrim dhe Përfshirje 2021-2027.

UNHCR-ja e përfundoi ushtrimin Vjetor të Vlerësimit të Pjesëmarrjes me personat e interesuar në bashkëpunim me autoritetet, organizatat partnere dhe agjencitë e OKB-së si pjesë e një ekipi multifunksional. Stërvitja përbëhet nga diskutime në terren me refugjatët dhe azilërkuesit, për t'i dëgjuar perspektivat dhe sfidat e tyre me të cilat përballen, si dhe një seminar me Ekipin Multifunksional për t'i diskutuar së bashku gjetjet në fushat e kushteve të prirjes, qasjes në të drejtat/shërbime, procedurën e përkufizimit të statusit të refugjatëve, dhe përcaktimin e rrugës më të mirë të veprimit bashkëpunues.

Si pjesë e projektit rajonal, FAO e ka mbështetur qeverinë për ta rritur qëndrueshmërinë klimatike në bujqësi përmes forcimit të sistemit të farës në vend, duke e përfshirë përmirësimin e prodhimit vendas të farërave të kulturave strategjike me cilësi të lartë dhe tolerante ndaj klimës, por edhe ndërtimin e kapaciteteve nacionale për të siguruar furnizimin e duhur të farës për fermerët. Në bashkëpunim me Institutin e Bujqësisë në Shkup, FAO hapi lokacione demonstrimi në Kočanë dhe Shkup për prodhimin, testimin dhe shumëzimin e materialeve cilësore të farës së fasuleve, specave dhe drithërave, duke ndihmuar në vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike në prodhimin bujqësor në kushte të ndryshme, si dhe efektet e aplikimit të masave të ndryshme agroteknike me vëmendje të veçantë ndaj mbrojtjes dhe burimit ushqyes të këtyre kulturave, si parakushte të rëndësishme për prodhimin të qëndrueshëm bujqësor. Falë këtyre aktiviteteve do të merret një material me farë cilësore dhe do të vihet në dispozicion për t'u shpërndarë fermerëve të interesuar. Gjithashtu, 45 fermerë, prodhues bujqësorë, përfaqësues të fermave të farës dhe kooperativave u trajnuan se si t'i përgjigjedhin, testojnë dhe kultivojnë farërat me cilësi të lartë për çdo kulturë, me qëllim të arritjes së rendimenteve optimale në rrethana të klimës së ndryshueshme.

Përmes një projekti tjetër, FAO e ka promovuar bujqësinë e mençur klimatike (BMK) për ta rritur qëndrueshmërinë e sektorit të bujqësisë. Dy pilot terrene për demonstrimin e praktikave të BMK-së dhe menaxhimit të qëndrueshëm të tokës u krijuan nga FAO - një në shkollën e mesme komunale "Dimitar Vlahov" në Strumicë, e cila e ka numrin më të madh të nxënësve të shkollave të mesme profesionale në vend, që mësojnë bujqësi dhe një tjetër në objektin e Kooperativës Bujqësore "Petrushka Reka" në fshatin Miravci të Gjevgjelijës. Nxënësit dhe fermerët nga të dy rajonet do të marrin pjesë në demonstrime dhe trajnime në terren mbi praktikën e BMK-së për prodhimin e perimeve në tunelet moderne plastike të lartë të pajisura me teknologji inovative BMK, duke përfshirë hidroponikë.

FAO e filloi një projekt të ri duke ndihmuar Qeverinë dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në krijimin e një Sistemi Nacional Informativ Kombëtar për Kafshët, për t'i mbështetur përpjekjet

e integritit të vendit në BE në fushën e shëndetit të kafshëve dhe sigurisë ushqimore. Njëpërmjet një projekti tjetër të ri, FAO po punon me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave për zhvillimin e një nënsektori konkurrues dhe të qëndrueshëm të bagëtive, që kontribuon në gjenerimin e punësimit në zonat rurale dhe përmirësimin e të ushqyerit të popullatës.

Përveç aktiviteteve të vazhdueshme për konsolidimin e tokës bujqësore, FAO e ka mbështetur zhvillimin e integruar të komunitetit lokal në disa fshatra, duke përfshirë rinovimin e shtëpisë kulturore lokale në fshatin Spancevë (Komuna Çeshinovë-Obleshevë), instalimin e një pajisje moderne ndriçimi në shkollën fillore në fshatin Sokollarcë (Çeshinovë-Obleshevë) dhe renovimin e shkollës fillore në fshatin Egri (Komuna e Manastirit). Pilot aksione të ngjashme janë duke vazhduar edhe në fshatin Optičarë

të Komunës së Manastirit.

Njëpërmjet projektit BE-FAO MAINLAND, ndërtimi i infrastrukturës së re bujqësore ka përpunuar në 336 ha të zonës së konsolidimit të tokës bujqësore në fshatin Egri, duke përfshirë ndërtimin e kanaleve të reja kulluese, zgjerimin e rrjetit ekzistues të vaditjes dhe ndërtimin e rrugëve me zhavorr - duke synuar rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së 214 fermerëve/pronarëve.

Në Fokus Common Agenda

"Ne gjendemi para një pikë kthesë historike. Në sprovën tonë më të madhe të përbashkët që nga Lufta e Dytë Botërore, njerëzimi përballen me një zgjedhje të ashpër dhe urgjente: para dështimit ose përparimit."

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guteresh

Në vitin 2020, në mes të shpërthimit të pandemisë COVID-19 që mori një numër të madh në jetë dhe mjete jetese dhe na kujtoi se si krizat globale mund të zgjidhen vetëm me bashkëpunim dhe zgjidhje globale, liderët botërorë u mbledhën praktikisht për ta miratuar deklaratat që e shënon 75 vjetorin e Kombeve të Bashkuara me 12 zotime kryesore për të ardhmen tonë. Në të njëjtën kohë, ata i kërkuar Sekretari të Përgjithshëm Antonio Guteresh "të raportojë" para përfundimit të sesionit të 75-të të Asamblesë së Përgjithshme "me rekomandime për të ecur përpara agjendën tonë të përbashkët dhe për t'u përgjigjur sfidave aktuale dhe të ardhshme".

Në raportin e tij "Agjenda jonë e përbashkët" Sekretari i Përgjithshëm e paraqet vizionin e tij për të ardhmen e bashkëpunimit global nëpërmjet një multilateralizmi gjithëpërfshirës, të rrjetëzuar dhe efektiv. OKB-ja u angazhua në përgatitjen e këtij raporti me një spektër të gjerë palësh të interesuara, duke përfshirë Shtetet Anëtare, bartësit e idesë, të rinjtë, shoqërinë civile dhe sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe partnerët e shumtë.

Agjenda jonë e përbashkët është agjendë veprimi, e krijuar për t'i fuqizuar dhe përshpejtuar marrëveshjet shumëpalëshe - veçanërisht Agjendën 2030, duke bërë ndryshime të prekshe në jetën e njerëzve. Ajo përmban rekomandime në 4 fusha të gjera:

Së pari, një solidaritet i rinovuar maksim popujve dhe brezave të ardhshëm, duke filluar nga plani i vdisimit për të gjithë dhe veçanërisht ata që kanë më shumë nevojë për të, si dhe hapa të guximshëm për t'i adresuar çështjet e ndërlydhura mjedisore siç është përkeqësimi i klimës, humbja e biodiversitetit dhe ndotja që e shkatërrojnë planetin tonë.

Së dyti, një marrëveshje e re sociale midis qeverive dhe njerëzve të tyre dhe brenda shoqërive, për ta rindërtuar besimin përmes konsultimit dëgjimor me të gjithë qytetarët. Marrëveshja sociale duhet të ankorohet në të drejtat e njeriut në mënyrë që njerëzit t'i shohin rezultatet të reflektuara në jetën e tyre të përditshme. Kjo përfshin pjesëmarrjen aktive dhe të barabartë të grave dhe vajzave, aranzhimet e zgjeruara të qeverisjes për të ofruar të mira publike më të mira dhe një epokë të re të mbrojtjes universale sociale, mbulimit shëndetësor, arsimit, aftësisë, punës së denjë dhe strehimit, duke përfshirë qasjen universale në internet deri në vitin 2030, si e drejta themelore e njeriut.

Së treti, një menaxhim më i mirë i pikave të përbashkëta kritike globale, siç është një konsensus i përbashkët, i mbështetur në mënyrë empirike rreth fakteve, shkencës dhe njohurive. Për këtë arsye, është më rëndësi thelbësore t'i jepet fund "infodemisë" dhe "luftës kundër shkencës". Vendimet e politikave dhe buxhetit duhet të bazohen në argumente shkencore dhe të ekspertëve, gjë që kërkon një kod global sjelljeje që e promovon

integritetin në informacionin publik.

Së katërti, të mira publike globale, të cilat janë në dispozicion të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjithë. Mënyra si llogariten sot Bruto Prodhimet Vendore (BPV), nuk arrin të kapë dështimin njerëzor dhe mjedor të disa aktiviteteve të biznesit. Prandaj Sekretari i Përgjithshëm bën thirrje për masa të reja për ta plotësuar BPV-në, në mënyrë që njerëzit të kenë një kuptim të plotë të ndikimeve të aktiviteteve të biznesit, gjegjësisht si mund dhe duhet të veprojnë më mirë për t'i mbështetur njerëzit dhe planetin tonë.

Është më rëndësi thelbësore të sigurohet mendimi afatgjatë, për t'i ndihmuar brezat e ardhshëm të përgatiten më mirë për sfidat e ardhshme, nëpërmjet angazhimit aktiv dhe kuptimplotë të të rinjve brenda dhe jashtë Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë përfaqësimin më të mirë politik dhe duke transformuar arsimin, trajnimin e aftësisë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Kjo mund të realizohet me një Këshill të Kujdestarisë së ripërcaktuar, një Laborator të së Ardhmes, një Deklaratë për Gjeneratat e Ardhshme dhe një të Dërguar Special të Kombeve të Bashkuara për të siguruar që vendimet e politikave dhe buxhetit ta marrin parasysh ndikimin e tyre të brezat e ardhshëm. OKB-ja do të ndihmojë në përgjigje të rreziqeve kryesore globale, duke publikuar një Parashikim Strategjik dhe Raport të Rrezikut Global në baza të rregullta: si dhe një Platformë të propozuar emergjence, që do të mbledhet si përgjigje ndaj krizave komplekse globale.

Së fundi, Sekretari i Përgjithshëm argumenton fuqishëm për multilateralizëm efektiv, në një kohë ndarjesh, thyerjesh dhe mosbesimi. Kjo kërkon Kombe të Bashkuara efektive, të aftë për t'u përshtatur me sfidat globale duke u mbështetur në qëllimet dhe parimet e Kartës së tyre. Në këtë frymë, Sekretari i Përgjithshëm propozoi një Samit të së Ardhmes për të krijuar një konsensus të ri global mbi atë se si duhet të duket e ardhmja jonë dhe se çfarë mund të bëjmë sot për ta siguruar atë. Një Bord Këshillimor i Nivelit të Lartë, i udhëhequr nga ish-krerë shtetesh dhe qeverish, mund të jetë i dobishëm në identifikimin e të mirave publike globale dhe fushave të tjera me interes të përbashkët, ku nevojiten më shumë përmirësime të qeverisjes propozime të opsioneve se si mund të arrihet ajo.

Në veçanti gjatë krizës COVID-19 kemi dëshmuar sërish se njerëzimi është i aftë për arritje të mëdha, duke punuar së bashku. Prandaj, Agjenda e Përbashkët paraqet një udhërrëfyes për ta rimarrë këtë frymë pozitive, për ta rindërtuar botën tonë dhe për ta rifituar besimin e ndërsjellë në këtë moment vendimtar historik.

The latest version of the Sustainable Development Bulletin is available on UN North Macedonia website. For additional information, please contact rc-northmacedonia@un.org. Produced by the UN Resident Coordinator's Office in North Macedonia | 11 November 2021

www.un.mk